

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE**  
**Maj 2025**

| Nr. | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Data e përgjigjes | Përgjigje                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|-----|-----------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------|--------|
| 1   | 06.05.2025      | <p>I nderuar Zoti Çako,</p> <p>Prej 4 ditësh, Ardit Beshiri është mbuluar nga masivi i kromit në Qafën e Burrelit dhe akoma nuk është zbuluar.</p> <p>Duke qenë se është një situatë e rëndë, do ju lutesha të na shpjegoni arsyet se pse burimet njerëzore dhe teknologjike të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile nuk janë angazhuar në kërkim.</p> <p>Gjithashtu do ju lutesha të na informoni nëse do merren masa nga institucioni që ju drejtoni për të ofruar asistencë për gjetjen e Ardit Beshirit.</p> <p>Duke ju falenderuar, A K</p> | 06.05.2025        | <p>informacioni lidhur me ngjarjen e Dibres, është si me poshte:</p> <p>Rrëshqitje masive dheu në fabrikën e përpunimit të kromit në Klos – vijon operacioni për gjetjen e punonjësit të zhdukur</p> <p>Rreth orës 14:30 te dates 3 maj 2025, në vendin e quajtur “Qafa e Burrelit”, në ambientet e fabrikës së përpunimit të kromit që ndodhet në territorin e bashkisë Klos, ka ndodhur një rrëshqitje masive dheu. Ngjarja e rëndë ka përfshirë një mjet tip ekskavator dhe ka mbuluar një punonjës të kompanisë që operon në shfrytëzimin e mineraleve në këtë zonë.</p> <p>Menjëherë pas ngjarjes, janë angazhuar forca të shumta në përpjekje për të gjetur dhe nxjerrë trupin e punonjësit të zhdukur.</p> |                                  |        |

|  |  |  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |  |
|--|--|--|--|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
|  |  |  |  | <p>Në operacionin kompleks janë përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi i bashkisë Klos,</li> <li>• Forcat e Policisë,</li> <li>• Punonjës të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM),</li> <li>• Ekip mjekësor me autoambulancë,</li> <li>• Forca vullnetare nga komuniteti,</li> <li>• Efektivë të Forcave të Armatosura me pajisje për detektimin e metaleve,</li> <li>• Punonjës të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.</li> </ul> <p>Rrëshqitja e ndodhur përfshin një masë të konsiderueshme dheu, me përmasa të vlerësuara rreth 500 metra gjatësi, 20 metra gjerësi dhe mbi 4 metra thellësi. Terreni në zonën e prekur mbetet i paqëndrueshëm, çka ka sjellë vështirësi të mëdha në</p> |  |
|--|--|--|--|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|

|   |            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |  |  |
|---|------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|
|   |            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |            | <p>ndërhyrjen me mjete të tjera të rënda, për shkak të rrezikut të rrëshqitjeve të mëtejshme. Për këtë arsye, ndërhyrjet po kryhen me kujdes ekstrem, për të shmangur çdo rrezik shtesë për forcat e angazhuara në operacion.</p> <p>Pavarësisht përpjekjeve të pandërprera, deri në këto momente nuk është bërë e mundur lokalizimi apo nxjerrja e trupit të punonjësit të ekskavatorit. Operacioni i kërkimit nën vijon me përkushtim maksimal, duke respektuar të gjitha protokollet e sigurisë dhe në bashkëpunim të ngushtë mes institucioneve përkatëse.</p> <p>Dite te mbare!</p> |  |  |
| 2 | 23.05.2025 | <p>Të nderuar,</p> <p>Më 23 maj 2025, ndodhi një incident i rrezikshëm në dyqanin LC Waikiki pranë Librit Universitar në Tiranë, ku u detyrova të përdor shkallët elektrike me karrocë pasi mungonte çdo formë tjetër aksesueshmërie për prindërit me fëmijë. Si pasojë, unë dhe djali im u rrëzuam. Ngjarja ishte e rrezikshme dhe për fat nuk pati pasoja më të rënda.</p> | 27.05.2025 | <p>Përshëndetje!</p> <p>Faleminderit për emailin tuaj!</p> <p>Ju informojmë se Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është person juridik publik dhe përgjigjet për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe garantimin e</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |  |  |

|   |  |                                                                                                                                                                                                                                |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |  |  |
|---|--|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|
|   |  | <p>Kjo situatë përbën shkelje të të drejtave të konsumatorit dhe vendos në rrezik sigurinë e qytetarëve. Kërkoj ndërhyrjen tuaj për inspektim dhe marrjen e masave ndaj subjektit tregtar në fjalë.</p> <p>Me respekt, E.L</p> |  | <p>mbrojtjes civile në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Qëllimi i saj është mbrojtja e jetës së njerëzve, gjësë së gjallë, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga dëmtimet apo rreziku i dëmtimit, si pasojë e fatkeqësive.</p> <p>Duke qenë se kërkesa juaj nuk është në fushën tonë të përgjegjësisë, ju lutemi që t'ia drejtoni atë institucionit përkatës.</p> <p>Faleminderit për mirëkuptimin!</p> |  |  |
| 3 |  |                                                                                                                                                                                                                                |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |  |  |